




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave



5-8-2011

V E N D I M

Nr. 543, datë 27.7.2011

PËR

PËRCAKTIMIN E MARZHEVE TË FABRIKIMIT
DHE TË TREGTIMIT TË BARNAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimi maksimal i tregtimit të barnave nga fabrikuesit vendas caktohet duke shtuar deri në 20 (njëzet) për qind mbi koston e fabrikimit.
2. Çmimi maksimal i tregtimit me shumicë të barnave nga importuesit dhe shpërndarësit farmaceutikë caktohet duke shtuar deri në 14 (katërmëdhjetë) për qind mbi çmimin CIF të importit të barit, e konvertuar në lekë sipas kursit mesatar të njoftuar nga Banka e Shqipërisë, për çdo 6-mujor.
Për barnat e fabrikuara në vend çmimi maksimal i tregtimit llogaritet bazuar mbi çmimin EXW.
Marzhi 14 (katërmëdhjetë) për qind ndahet ndërmjet importuesit dhe shpërndarësit, përkatësisht, 10 (dhjetë) për qind dhe 4 (katër) për qind.
3. Çmimi maksimal i tregtimit me pakicë të barnave caktohet duke shtuar deri 29 (njëzet e nëntë) për qind mbi çmimin e blerjes nga shpërndarësi farmaceutik.

4. Për barnat e listës që rimburohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor zbatohen marzhe të diferencuara, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.


5. Për barnat që blihen nga institucionet shëndetësore publike çmimi maksimal i tregtimit caktohet duke shtuar deri në 10 (dhjetë) për qind mbi çmimin CIF ose EXW dhe për disa nga këto barna zbatohen marzhe të diferencuara, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Vendimi nr. 56, datë 28.1.2005, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit të barnave”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I SHËNDETËSISË

PETRIT VASILI

NR.PROT.2250/1
DATE 3.8.2011

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA
Sekretari i Përgjithshëm

